

SITUATA NË KOSOVË: VLERËSIM I GJENDJES

Shpërndarja:
I përgjithshëm
Sarajevë, 14 shtator 2010
ICMP.DG.264.4.alb.doc

ICMP

Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) përqipet të sigurojë bashk; punimin e qeverive dhe autoriteteve tjera në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur si pasojë e konflikteve të armatosura, armiqsive tjera ose shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe i ndihmon qeveritë për ta bërë këtë. ICMP gjithashtu përkrahë punën e organizatave tjera në përpjekjet e tyre, inkurajon përfshirjen e publikut në aktivitetet e tij dhe i kontribon zhvillimit të shprehjes së duhur të përkujtimit dhe respektit për të zhdukurit.

ICMP është organizatë ndërkombëtare e cila aktualisht po i ofron ndihmë qeverive *inter alia* në Ballkanin Perëndimor, Amerikën Jugore, Lindjen e Mesme dhe Azinë Juglindore. Për më tepër, ICMP punon me qeveritë për tu siguruar se të drejtat e viktimave janë realizuar në këtë process, duke përfshirë këtu edhe konceptin se të afërmit e të zhdukurve kanë të drejtë për informacion në lidhje me fatin e personave të zhdukur, dhe se ata kanë të drejtë në informata të sakta dhe të besueshme në lidhje me kërkimin, zhvarrimin dhe procesin e identifikimit.

Në këtë drejtim, ICMP ndihmon qeveritë në ndërtimin e kapaciteteve të tyre për të trajtuar këtë çështje, përmes krijimit të institucioneve të duhura të sundimit të ligjit, legjislacionit dhe shprehjes së kujtimit. ICMP gjithashtu punon me shoqërinë civile përfshirë këtu edhe shoqatat familjare të personave të zhdukur.

ICMP ofron ndihmë teknike për të përkrahur procesin e gjetjes, zhvarrimit dhe identifikimit të personave të zhdukur. Në programin e vetë të ndihmës teknike, ICMP ndoshta është më së miri e njohur si pioniere e aplikimit të identifikimit përmes ADN-së të personave të zhdukur në shkallë të gjerë.

ICMP gjithashtu, përkrah punën e institucioneve në sektorin e drejtësisë, përfshirë këtu edhe sistemin vendor të drejtësisë penale. Ofron ad hoc ndihmë edhe në rastet e fatkeqesive.

PËRMBAJTJA

I.	PRËMBLEDHJE	4
II.	HYRJE	6
III.	INICIATIVAT E FUNDIT	8
IV.	VLERËSIM I GJENDJES	10
	4.1. Shqyrtim i numrave të personave të raportuar si të zhdukur	10
	4.2. Shqyrtimi i Procesit të Identifikimit.....	11
	4.3. Vlerësim i identifikimeve të gabuara.....	16
V.	KONKLuzionET	17
VI.	REKOMANDIMET	18
	6.1. Shqyrtimi i përbashkët	18
	6.2. Grupi i Politikave.....	18
	6.3. Arkivi Qendror i te Dhenave	19
	6.4. Ligji i Kosovës për Personat e Zhdukur	19
	6.5. Komisioni i Qeverisë së Kosovës për Persona të Zhdukur.....	19
	6.6. Angazhimi i Shtuar i Familjeve të Personave të Zhdukur	19
	Annex 1: FIGURAT	20
	Annex 2: FJALORI.....	22

VLERËSIM I GJENDJES

Në lidhje me Çështjen e Personave të Zhdukur nga Konflikti në Kosovë

I. PËRMBLEDHJE

1. Numri i madh i personave të zhdukur si rezultat i shkeljes së të drejtave të njeriut, është një përkujtim i gjallë i dështimit të mbrojtjes së të drejtave individuale dhe vendosjes së sundimit të ligjit. Përveç kësaj, ky numër përjetëson spektrin e një të kaluarë të dhimbshme, rëndon brishtësinë e paqes dhe procesin e pajtimit, dhe është pengesë për zhvillimin e shoqërisë demokratike nëpërmjet institucioneve të efektshme llogaridhënëse dhe të drejta. Adresimi i çështjes së të zhdukurve për këtë arsye është një shqetësim me rëndësi jetike.
2. Është vlerësuar se rreth 4,500 persona janë zhdukur si pasojë e konfliktit të Kosovës. Pas më shumë se një dekade të përpjekjeve intensive, rreth gjysma e këtyre personave të zhdukur janë gjetur, identifikuar me saktësi dhe eshtrat e tyre janë kthyer për varrim. Përgjegjësia kryesore teknike e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP) në Kosovë ka qenë për ti siguruar Kombeve të Bashkuara, Misioni i Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK) dhe sot Misionit të Bashkimit European për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX)¹, sistem të identifikimit të udhëhequr me ADN. Deri në 9 gusht 2010, në lidhje me konfliktin në Kosovë, ICMP ka lëshuar raporte përputhëse të ADN-së për 2,304 persona të zhdukur, bazuar në 14,517 referenca gjenetike që ICMP-ja ka mbledhur nga anëtarët e familjes.
3. Përkundrejt këtijë përparimi, kërkimi për të zhdukurit ka arritur pikën e bllokimit virtual. Faktorët të cilët i kontribuojnë kësaj ngecjeje janë të shumfishtë, por tre shkaktarë themelorë janë të identifikueshëm. Arsyeja e parë e rëndësishme është se shkalla e gjetjeve dhe zhvarrimeve të mbetjeve mortore të personave të zhdukur ka rënë në mënyrë dramatike që nga viti 2005. Në Serbi nuk janë zhvarrosur mbetje mortore që nga operacionet e zhvarrimeve të ndërmarra në vitin 2001 dhe 2002². Në Kosovë pjesa më e madhe e mbetjeve mortore janë zhvarrosur herët gjatë procesit, kryesisht përmes përpjekjeve të Tribunalit Penal Ndërkombëtarë për ish Jugosllavi (ICTY) dhe më vonë UNMIK-ut (nga viti 1999 gjer më 2003). Në përgjithsi numri i varrezave klandestine të gjetura për çdo vit ka rënë dukshëm që nga viti 2005.
4. ICMP pranon mostrat biologjike të marra nga mbetjet mortore të gjendura në varrezat ilegale të cilat i parashtrohen ICMP-së nga të dyja misionet ndërkombëtare dhe autoritetet qeveritare. Në këtë kontekst, faktori i dytë ndërlikues është se Zyra e EULEX-it për mjekesi ligjore (OMPF)³ dhe zyrtarët Serb shpesh kanë bërë parashtrimin e më shumë se një mostre për të njëjtin person⁴, dhe disa nga mostrat nuk përmbanin ADN të mjaftueshme për të nxjerrë profilin e ADN-së⁵. Mesatarisht 1.15 mostra për një individë janë parashtruar nga autoritetet Serbe dhe 1.9 mostra janë parashtruar nga UNMIK-u dhe EULEX-i për të njëjtin person. Në tërësi, në kontekstin e konfliktit të Kosovës 38.9% e mostrave

¹Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është themeluar në vitin 1999, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB, si administratë e përkohshme në Kosovë. Në vitin 2002 UNMIK-u krijoi Zyrën për Persona të Zhdukur dhe Mjeksi Ligjore (OMPF). Pas krijimit të Misionit të Bashkimit European për Sundimin e Ligjit (EULEX) në vitin 2008, OMPF u transferua tek EULEX-i. OMPF ka "mandat të dyfishtë" i cili përfshihet "Zbardhjen e fatit të personave të zhdukur" dhe "ofrimin e sistemit mjeko ligjor në Kosovë me Standarde Europiane."

²Në mes të 2001 dhe 2002, 840 persona u zhvarrosën nga varrezat klandestine në territorin e Serbisë. Edhe pse vazhdonë të ketë supozime për ekzistimin e vendvarrezave tjera, e fundit ajo në qytetin e Serbisë Juglindore Raska, nuk janë gjetur varreza shtesë në 8 vitet e fundit. ICMP ka ndihmuar Serbinë në zhvarrimin dhe identifikimin e mbetjeve mortore përmes përdorimit të ADN-së. Të gjitha mbetjet mortore të zhvarrosura në Serbi në mes të viteve 2001-2002 ishin të Shqiptarëve të Kosovës të ekzekutuar në vitin 1999. Këto mbetje ju transferuan UNMIK-ut dhe ky proces u përfundua në mes të Serbisë dhe UNMIK-ut në mesin e vitit 2006.

³Me 23 gusht 2010, OMPF u riemrua në Departamenti i Mjeksisë Ligjore (DML)ë Ky raport i Vlersimit të Gjendjes i referohet OMPF siç është raportuar në punën e mëhershme.

⁴Për shembull, në një rast që kishte të bënte me mbetjet mortore të gjetura në territorin e Kosovës në fshatin Ruhot, 22 mostra biologjike u parashtruan për identifikimin e një individi.

⁵Mesatarja e përqindjes së nxjerrjes së ADN-së diskutohet në paragrafin 42.

biologjike⁶ të cilat i janë parashtruar ICMP kanë bërë të mundur identifikimin e personave të cilët më parë nuk ishin identifikuar me ADN. Vitin e kaluar, shkalla e identifikimeve me anë të ADN-së ka rënë dukshëm nga 38.9 % në rreth 4.68%.

5. Faktori i tretë kontribues i cili pengon përparimin e mëtejshëm është se në pjesë e identifikimeve të mëhershme të bëra pa ADN, në periudhën 1999 deri në vitin 2003, janë jo të sakta. Në Raportin e Vlerësimit të Gjëndjes të publikuar në vitin 2005⁷, ICMP pati theksuar mundësinë e identifikimeve të gabuara. ICMP fuqishëm rekomandon që shkalla e këtyre identifikimeve të gabuara të shqyrtohet në mënyrë të detajuar.
6. Vlen të theksohet se në dhjetor të vitit 2004, UNMIK - OMPF raportoi se " shumica e trupave të personave të konsideruar të zhdukur janë zhvarrosur"⁸ dhe në të vërtetë, pothuajse gjashtë vjetë më pas, ICMP ka pranuar nga OMPF mostra të mbetjeve skeletore të cilat mund të llogarisin vetëm 521⁹ persona të zhdukur të pidentifikuar më parë me anë të ADN-së. Pjesa më e madhe e testeve të ADN-së nga mbetjet të cilat mbahen nga OMPF është kryer. Numri i vogël prej 521 nuk reflekton vetëm rënjen drastike të mbetjeve të zhvarrosura nga varrezat klandestine në 5 vitet e fundit, por në të njëjtën kohë ngre pyetjen se si është e mundur që shumica e trupave janë zhvarrosur tashmë, kur akoma janë edhe rreth 2,000 persona të regjistruar si të zhdukur. Analizat e ICMP's tregojnë se kësajë pyetje, gjithashtu i duhet kushtuar vëmendje serioze.
7. Aktualisht, ICMP ka një sasi të profileve¹⁰ gjenetike familjare për 2,011 persona akoma të zhdukur të përfaqësuar në bazën e të dhënave të tij për Kosovën, dhe akoma asnjë nga ta nuk perputhet me 693¹¹ profilet e dallueshme gjenetike të marra nga mbetjet skeletore të cilat gjithashtu gjenden në bazën e të dhënave të ICMP. Ajo që shqetëson më tepër është se numri i qëndrueshem i 413 profileve gjenetike të marra nga mostrat postmortem të pranuar nga OMPF, të marra nga mbetjet mortore të cilat ruhen në morgun e Prishtinës, nuk është përputhur me asnjë profil gjenetik të gjeneruar nga mostrat referente të gjakut për një kohë të konsiderueshme, në disa raste për pothuajse nëntë vite¹². Ky fakt forcon më shumë nevojën e shqyrtimit të problemit dhe shtrirjes së identifikimeve të gabuara.
8. Vazhdimi i ri-ekzaminimit rast për rast i rasteve të mbyllura më parë mund të ofrojë një mundësi për progres, megjithatë, kjo nuk mund të shmangë nevojën për qasje strategjike, përfshirë këtu edhe shqyrtimin e gjerë të punës së kaluar, dhe as procedimin e menjëhershëm pa përfshirjen e aktive të vendimarrësve vendorë.
9. Hapi i parë në këtë drejtim duhet të jetë që EULEX dhe ICMP të hartojnë një plan punues të përqëndruar në përcaktimin e shkallës së gabimeve në të kaluarën në procesin e identifikimit dhe strategjinë për të trajtuar këtë problem.
10. Duke marrë parasysh ngecjen aktuale të theksuar në këtë raport dhe në mungesë të një çasjeje strategjike për të trajtuar këtë problem, ICMP së shpejti do të jetë në pozitë ku nuk mundet më tutje të ofrojë ndihmë teknike për procesin përmes punës në identifikim.

⁶ Mostrat e preferuara janë kocka dhe dhëmbi. Shif fjalorin për termat teknik.

⁷ Shif *Situata në Kosovë: Vlersim i Gjendjes*, ICMP.FSD.18.05.doc, see <http://www.ic-mp.org/wp-content/uploads/2007/11/icmp-fsd-18-05-1-doc.pdf>.

⁸ OMPF, Raport i Aktiviteteve 2002-2006, f. 6.

⁹ Ky është numri i rasteve të hapura sipas Numrit Minimal të Individëve të kalkuluar nga OMPF. Ky numër përfshinë të paktën 89 mostra të parashtruara nga OMPF nga rastet e identifikuara më herët pa ADN, të cilat janë hetuar me kërkesë të familjes për të konfirmuar identifikimin e mëhershëm.

¹⁰ Ju lutem shif paragrafin 54 për diskutimin rreth numrave të mbledhur të referencave familjare.

¹¹ Kjo figure përfshinë të gjitha profilet e dallueshme të ADN-së nga mbetjet skeletore në bazën e të dhënave për Kosovë të ICMP-së të cilat nuk kanë prodhuar përputhje me referencat familjare. Disa nga këto kanë të bëjnë me rastet të cilat konsiderohen nga OMPF si të identifikuara dhe të "mbyllura," por ICMP nuk ka çasje në shënimet të cilat tregojnë se cilat raste janë mbyllur, nga kush, ose në çfarë baze. Llogaridhënja e plotë e çështjes e bazuar në shqyrtimin e përbashkët të të dhënave dhe ripajtimi do të ishin më se të dëshirueshëm

¹² Shif faqen 13, Figura 1: Tabela e numrave të mostrave të eshtrave nga rastet aktualisht të hapura në morgun e OMPF, për të cilët ICMP ka profil të papërpunuar të ADN-së në bazën e tij të të dhënave.

II. HYRJE

11. Duke pasuar përfundimin e konfliktit në Kosovë, detyra e gjetjes, zhvarrimit dhe identifikimit të personave të zhdukur është ndërmarrë kryesisht nga organizatat nëdrkombëtare¹³. Pas më shumë se një dekade të përpjekjeve intensive, përafërsisht gjysma e personave të raportuar të zhdukur nga konflikti, është gjetur, identifikuar saktësisht dhe i është kthyer familjeve për varrim.
12. Përgjegjësia kryesore e ICMP-së në Kosovë ka qenë ti ofrojë UNMIK-ut dhe tani EULEX-it sistemin e identifikimit të udhëhequr nga ADN-ja. Kjo ndihmë është dhënë në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit të cilin UNMIK dhe ICMP e nënshkruan në nëntor të vitit 2003, i cili akoma shërben si bazë për përkrahje për EULEX-in.
13. ICMP ka zhvilluar një sistem të lartë të identifikimit përmes ADN-së i cili për here të pare mundësonë identifikimin përmes metodave shkencore, të një numri të madh të personave të zhdukur si rezultat i konflikteve të dhunshme. Për këtë qëllim, ICMP posedon kapacitetin operacional më të lartë në botë për nxjerrjen e ADN nga mbetjet skeletore. Në procesin e përputhjeve gjenetike të udhëhequr nga ADN, profilet e ADN-së nga mbetjet skeletore, përputhen me profilet e anëtarëve të mbijetuar të familjeve të të zhdukurve me qëllim të gjetjes së përputhjeve ADN të lidhjeve familjare me një saktësi të jashtëzakonshme shkencore, për të ofruar bazën e identifikimit të besueshëm dhe të saktë.
14. Pjesa dërmuese e identifikimeve të bëra në ish Jugosllavi, pas luftrave të fundit nuk do të kishte qenë e mundur pa sigurinë objektive të ADN-së. Në përgjithësi, ka një mungesë të të dhënave mjeksore, dentare dhe gjurmëve të gishtrinjeve të cilat do të mundësonin identifikimin e saktë edhe në mungesë të ADN-së. Shënimet antemortem të ofruara nga familjet, profilet biologjike postmortem të të zhdukurve, informatat rrethimore dhe gjësendet personale mund të kenë një rol në procesin e identifikimit, por vlerësimi i rëndësisë së tyre është shumë subjektiv.
15. Në nivelin e shoqërisë, përdorimi i ADN-së në një mjedis të ngarkuar politikisht, të dalë nga konflikti mund të jetë i një rëndësie të madhe në parandalimin e mohimit, manipulimit dhe ndërtimit të miteve të cilat pa dyshim shfrytëzojnë pasigurinë në lidhje me identitetin e personave të zhdukur. Përdorimi i ADN-së mundëson llogaritjen e saktë të numrit të përgjithshëm të personave të zhdukur dhe gjithashtu mund të zbulojë gabimet e bëra me përdorimin e mjeteve më pak të besueshme. Përderisa këto gabime nuk trajtohen në mënyrë të përgjegjshme dhe transparente, ato rrezikojnë të kontribuojnë jo vetëm në traumat emocionale të familjeve të të zhdukurve por edhe keqpërdorimin politik të çështjes.
16. Ndihma Kosovës, përbën rreth një të katërtën e punës së përgjithshme mjekoligjore të ICMP-së të bazuar në ADN në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Është një jesë e madhe duke llogaritur 3,942 raporte përputhëse të cilat i janë parashtruar autoriteteve gjatë viteve dhe përfaqeson 2,304 persona të zhdukur të cilat si rezultat i sajë janë identifikuar.
17. Përkundrajt suksesit të dukshëm në ofrimin e numrit të madh të identifikimeve të bazuara shkencore, duket se procesi është duke humbur momentumin. Familjet e të zhdukurve dhe të tjerët janë të shqetësuar për faktin se rreth gjysma e të zhdukurve akoma nuk është gjetur dhe se ka edhe të paktën 413 individë në morgun e Prishtinës të cilët nuk mund të identifikohen¹⁴. Që nga marsi i vitit 2005, gjithashtu ka patur rënie drastike të shkallës së gjetjes së mbetjeve të personave të cilët u zhdukën si rezultat i konfliktit, gjë e cila ka bërë që të ketë rënje të theksuar të identifikimeve me ADN. Ka gjithashtu konflikt të numrave të personave të raportuar të zhdukur, pasiguri se kush duhet të konsiderohet person i zhdukur si rezultat i konfliktit, numrat e viktimave të shaktuara në lidhje me konfliktin dhe pyetjet që kanë të bëjnë me gabimet e mundshme të bëra në 2,000 raste të mbyllura me

¹³ Agjencionet Kryesore të përfshira në këtë bashkëpunim në kohë të ndryshme përfshijnë, ICTY, UNMIK, EULEX, Komitetin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtarë (ICRC), ICMP, si dhe Forcën e Kosovës (KFOR) dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSCE).

¹⁴ OMPF thotë se janë 434 individë të pidentifikuar në NMI, por numri i ICMP është 413, shif paragrafin 46 për detaje.

metoda jo-ADN, para se ICMP dhe UNMIK të nënshkruanin marrëveshjen në nëntorë të vitit 2003 në lidhje me procesin e identifikimit të udhëhequr nga ADN-ja¹⁵.

18. Përfshirja e organizatave ndërkombëtare në procesin e gjetjes, zhvarrimit dhe identifikimit të personave të zhdukur nuk është unike për Kosovën. Ka qenë trajtë e përbashkët pas konflikteve të fundit në Ballkanin Perëndimor. Rajoni ka përfituar në veçanti nga angazhimi i ICTY si dhe përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të zhvilluar institucionet e sundimit të ligjit pas konfliktit. Ka vetëm disa raste të ngjashme në botë, posaçërisht kur kemi të bëjmë me personat e zhdukur nga konfliktet e armatosura dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.
19. Megjithatë përpjekjet për zhvarrime në shkallë të gjerë të ICTY në rajon kanë patur si qëllim kryesorë hetimin, gjithashtu për qëllim kanë patur edhe identifikimin e mbetjeve mortore. Në Kosovë dhe Bosnje dhe Hercegovinë (B dhe H) një numër i madh i rasteve të personave të zhdukur të mbyllura më herët janë bërë duke përdorur metodat “tradicionale” ose metodat pa ADN, pa një proces të aplikuar në mënyrë uniforme të hetimeve shkencore ose kritereve të definuara të përcaktimit të identitetit. Këto metoda të identifikimeve të mbetjeve humane përbëjnë rrezik të konsiderueshëm për gabime. Në rastin e Kosovës, infomacionet e disponueshme sugjerojnë se rreth 2,000 apo më shumë individë janë identifikuar gjatë viteve 1999 dhe 2002¹⁶. Është e paqartë se sa këso rastesh janë mbyllur zyrtarisht gjatë kësaj periudhe dhe, prapë, sa nga to nga ICTY dhe UNMIK repektivisht. Kjo çështje ndikon edhe në llogaritjen e numrit të përgjithshëm të personave të zhdukur nga konflikti sikurse në Grupet Punuese për Personat e Zhdukur në lidhje me ngjarjet në Kosovë të udhëhequra nga ICRC (këtu dhe më poshtë GP ose Grupet Punuese të ICRC), e cila në prill të vitit 2010 kishte gjithsej 1,862 persona.
20. Një vështirsi e përgjithshme në përcaktimin e numrit të plotë të personave të zhdukur, është përcaktimi i saktë se çfarë është “person i zhdukur.” Në këtë drejtim, përpjekjet e ICRC për të krijuar një listë të konsoliduar të të zhdukurve që rrjedh nga burime të ndryshme janë të lavdërueshme. Megjithatë, shkalla në të cilën popullata e raportuar “të zhdukur” mund të jetë e ndërthurur me viktime të kohës së luftimeve të tjera, të tilla si ushtarë të vrarë në luftë apo të atyre që kanë vdekur nga shkaqe natyrore, mund të kufizojë zbatimin praktik dhe analitik të listës në zgjidhjen e problemit siç është i paraqitur tani.
21. Megjithatë, ndihma ndërkombëtare mbi çështjen e personave të zhdukur në Kosovë ka qenë kryesisht e natyrës teknike, e përqëndruar pothuajse ekskluzivisht në studimin e dosjes kushtuar kërkesave për zgjidhjen e rasteve individuale të personave të zhdukur. Në vende të tjera të ballafaquara me një problem serioz të personave të zhdukur, qoftë në rajonin e Ballkanit Perëndimor apo diku tjetër, përpjekjet për të trajtuar çështjen e të pagjeturve nuk janë ndalur vetëm në studim të dosjes, por kanë kërkuar për të forcuar mekanizmat lokale, në bazë të ligjeve vendore dhe legjitimuar përmes proceseve demokratike lokale, megjithatë ato mund të jenë krijuar pas ndërprerjes së konfliktit.
22. Ajo që e bën procesin në Kosovë të dallojë nga fqinjët e saj në Ballkanin Perëndimor është se ka ardhur gjër këtu pa përfshirjen aktive, pjesmarrjen operacionale ose pronësinë e institucioneve demokratike të Kosovës. Në këtë moment, ka megjithatë shenja të qarta se autoritetet e Kosovës kanë shprehur rritje të interesimit në marrjen e përgjegjësive për çështjen e personave të zhdukur. Ky zhvillim duhet të shihet si i favorshëm dhe si i tillë të përkrahët për të mundësuar qeverisë që të marrë përgjegjësitë në një mënyrë jodiskriminuese, transparente dhe llogaridhënëse.
23. Duhet theksuar gjithashtu, se përgjegjësitë e qeverisë në lidhje me çështjen e personave të zhdukur janë të bazuara direkt në ligjet e obligueshme vendore. Kushtetuta e Kosovës ka inkorporuar instrumentat kryesorë të të drejtave të njeriut përfshirë këtu edhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR). Qeveria gjithashtu ka adoptuar Strategjinë dhe Planin Veprues për të Drejtat e Njeriut 2009-

¹⁵ Duket se nuk ka numër të saktë të sasisë së mbetjeve të zhvarrosura dhe të identifikuar mortore gjatë kësaj kohe; megjithatë, ka një pajtueshmëri të përgjithshme, bazuar në disa burime, përfshirë edhe ICTY dhe OMPF se rreth 2,000 raste janë zhvarrosur dhe identifikuar para përdorimit të ADN (Shif Raporti i Aktivitetëve të UNMIK OMPF, 2002-2004, faqe 6.).

¹⁶ Ibid.

2011, dhe gjykatat e Kosovës aplikojnë ligjet e ECHR. Sipas ECHR, Anëtarët e familjeve të personave të zhdukur kanë të drejtë për tu informuar në lidhje me fatin dhe vendndodhjen e më të afërmeve të tyre, gjë që është paraparë në Nenet 2, 3, dhe 5 të ECHR. Autoritetet e Kosovës, rrjedhimisht janë të obliguara të ndërmarrin të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të dhënë informata të tilla.

24. Po aq e rëndësishme sa obligimi i qeverisë për të dhënë përgjigje për secilin rast të personave të zhdukur, është edhe nevoja për të trajtuar çështjen si nevojë të shoqërisë. Numri i madh i personave të zhdukur është simbol i fuqishëm i dështimit të mbrojtjes së të drejtave individuale dhe vendosjes së rendit dhe ligjit. Ata janë përkujtues konstant i ndjeshmërisë dhe ekspozimit ndaj arbitraritetit. Përderisa nuk zgjidhet në mënyrë të paanshme dhe objektive, çështja i kontribon gjithashtu qëndrueshmërisë së atmosferës së mosbesimit dhe mundë të përkeqsojë brishtësinë e qeverisjes pas konfliktit e cila mund të ndikojë negativisht në kredibilitetin politik, demokratik dhe të insituacioneve të sundimit të ligjit. Përderisa kërkimi i përgjigjeve për secilin rast individual të personave të zhdukur është i domosdoshëm dhe kërkohet nga ligji, trajtimi i çështjes në nivelin e përgjithshëm të shoqërisë, ku edhe ndikon në kredibilitetin dhe perspektivën e një tranzicioni politik, është gjithashtu shumë me rëndësi.
25. Megjithatë, rrethanat shoqërore dhe politike nuk janë statike; trajtimi i çështjes së personave të zhdukur është një proces i zgjatur në kohë dhe që fillon gjatë armiqesive dhe vazhdon për një kohë të gjatë pas nderprerjes së dhunës. Është proces i cili urëzon ndryshimet dramatike shoqërore dhe mundë të sjellë ndryshimin e standardeve të punës dhe zhvendosjen e objektivave. Është pikërisht përkushtimi afatgjatë gjatë kohrave të ndryshimeve thelbësore që e bën çështjen e personave të zhdukur si rezultat i konflikteve të armatosura dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut të ndryshme dhe më të ndërlikuar se sa rastet e zhdukjeve tjera, për shembull ato si pasojë e fatkeqesive natyrore. Duke e bërë punën teknike të rasteve si qëllim të vetëm e thjeshtëson së tepërmi mjedisin pas konfliktit dhe punohet në dëm të zhvillimit të një përgjigje praktike në nivel të shoqërisë.
26. Proceset vendore për të trajtuar çështjen e personave të zhdukur ndihmojnë për tu siguruar se është trajtuar në një mënyrë më gjithpërfshirëse se e aktorve ndërkombëtarë të cilët punojnë vetëm nga mandati i tyre teknik, dhe është një gjë që mundë të arrihet. Mundësimi i proceseve vendore nuk do të thotë në vete më shumë identifikime të personave të raportuar akoma si të zhdukur, edhe pse mundë edhe të ndodhë. Proceset e duhura vendore do të mundësonin shoqërisë vlerësimin e situatës së personave të zhdukur, diskutojë opcionet e mundshme dhe marrjen e përfundimit të sukseseve dhe vështërsive të mundshme.
27. Përveç kësaj për të eksploruar iniciativat e fundit dhe duke siguruar një vlerësim të gjendjes në lidhje me punën e ICMP, seksionet e mëposhtme kanë për qëllim të përmbledhin informatat të cilat i ka në dispozicion ICMP për të kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve vendore. Ky raport i vlerësimit të gjendjes nuk mund të zëvendësojë një vlerësim shumë të nevojshëm shoqëror ose një shqyrtim të përbashkët nga aktorët ndërkombëtarë. Megjithatë, ajo ka për qëllim për të çuar përpara idenë se vetëm bashkëpunim më i ngushtë ndërkombëtar me qëllim të aftësisë të mekanizmave vendore mund të sigurojë një përfitim të qëndrueshme për paqen, drejtësinë dhe pajtimin.

III. INICIATIVAT E FUNDIT

28. Së fundmi në vitin 2009, EULEX ndërmori dy iniciativa të cilat ia vlen të përmenden. Në fillim të vitit EULEX gjeti mostra të mbetjeve në morgun e Prishtinës të cilat më parë nuk i ishin dërguar ICMP-së. Rrjedhimisht, një numër i vogël i personave të zhdukur u zgjidh. Megjithatë në shumicën e rasteve, u vërtetua se mostrat e parashtruara ju takonin mbetjeve të bashkuara skeletore të cilat ICMP i kishte identifikuar më parë përmes ADN-së. Edhe pse procesi i dërgimit të këtyre mostrave të vjetra ICMP-së ka vazhduar edhe në vitin 2010, shumë shpejt do të vijë koha kur kjo do të përfundojë dhe nuk do të mbetet më asgjë për të analizuar.

29. Në një iniciativë tjetër së fundmi, EULEX është anagzhuar në përpjekjet *ad hoc* për tu përgjigjur kërkesave të familjeve për identifikim me ADN për të konfirmuar punën identifikuese e cila fillimishtë ishte ndërmarrë në Kosovë pa përdorimin e ADN-së¹⁷. Nga 89 raste të tilla, ICMP arriti të shqyrtojë 77 prej tyre për të ciat kishte informacione të mjaftueshme të referencave gjenetike dhe gjeti që 13 nga identifikimet fillestare u provuan të kishin qenë jo të sakta. Kjo, prapë e konfirmon nevojën e shqyrtimit të çështjes së identifikimeve të gabuara në mënyrë specifike.
30. Iniciativat e fundit të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës, përfshirë edhe krijimin e Grupit të Politikave dhe përpjekjet për të forcuar kapacitetet e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur (GCMP), *inter alia*, sugjerojnë fillimin e zhvendosjes nga autoriteti ekskluziv ndërkombëtar tek përgjegjësia vendore mbi këtë çështje. Ky zhvillim duhet të përshejtohet përmes masave për ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetjes politike. Angazhimi vendorë është më se i nevojshëm për vënjen dhe çuarjen përpara të qëllimeve strategjike në këtë moment. Angazhimi vendorë është gjithashtu parakusht i domosdoshëm për trajtimin sistematik të problemit të identifikimeve të gabueshme në të kaluarën, sepse një strategji e tillë është e nevojshme të merrë parasyshë pasojat shoqërore, ligjore dhe politike të numrit të madh potencial të identifikimeve të gabuara të mbetjeve mortore.
31. Për më tepër, Grupi i Politikave i Qeverisë së Kosovës për personat e zhdukur¹⁸, ka kërkuar që të gjitha organizatat e përfshira, sidomos EULEX, ICRC dhe ICMP, të analizojë arsyet pse progresi është në një rrugë pa krye dhe që ata të punojnë së bashku për të zhvilluar një plan strategjik për të trajtuar problemet.
32. Në vitin 2009, ICMP nga ana e vet propozoi shqyrtim të përbashkët strategjik i cili do të mundësonte një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha të dhënave të disponueshme dhe dokumentave të cilët do të ndihmonin për të hedhur dritë mbi problemin dhe të identifikojë rrugën përpara. ICMP konsideron se një përpjekje e përbashkët e kryqëzimit të të dhënave të veta me të dhënat nga EULEX-i – përfshirë këtu edhe të dhënat mbi zhvarrimet, raportet e autopsisë, qertifikatat e vdekjes dhe një inventar i detajuar i mbetjeve mortore në morgun e Prishtinës – si dhe shkëmbimi i raportit të EULEX-it mbi vlerësimin e gjendjes, do të mundësonte kuptimin më të mirë të situates, përfshirë këtu edhe shkallën e gabimeve në këto identifikime të gabuara të bëra pa analizën e ADN-së.
33. Mundësia e të kuptuarit të problemeve aktuale teknike mund të çojë jo vetëm tek mbyllja e rasteve në morgun e Prishtinës, por gjithashtu mund të forcojë mundësinë e vlerësimit se sa mbetje mortore gjenden akoma të fshehura në varreza klandestine, jo vetëm në Kosovë por edhe gjetkë. Për shembull, një analizë e të dhënave gjeografike do të mundësonte përjashtimin e vendvarrimeve të njohura dhe parashikimin e lokacioneve të vendvarrezave të reja ku mbetje mortore shtesë mund të gjenden.
34. Ajo që duhet theksuar gjithashtu është se korrigjimi i situatës aktuale do të kërkojë rinovim të investimeve politike dhe financiare¹⁹. Për të siguruar përkrahjen e vazhdueshme, përfshirë edhe përkrahjen financiare për çështjen e personave të zhdukur në Kosovë, është qartësisht e nevojshme që në mënyrë të besueshme të demonstronhet perspektiva e progresit i cili mund të arrihet vetëm me përkushtim dhe energji të rinovuar.

¹⁷ Identifikimi i një individi bazuar në ADN i cili më pare ishte identifikuar me mjete pa ADN, i ndërmarrë me kërkesë të familjes për të vërtetuar identifikimin e mëhershëm. Në Kosovë, trupi zhvarroset nën autoritetin e Urhëresës së Gjykatës, dhe të afërmit ofrojnë mostra referente të gjakut dhe japin leje për examitime postmortem si dhe marrjen e mostrave biologjike nga personi i zhdukur në fjalë

¹⁸ Është krijuar në vitin 2009 për të mbikqyrur progresin në çështjen e prsonave të zhdukur.

¹⁹ ICMP nga ana e tijë për punën në Kosovë është përkrahur nga qeveritë e Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Norvegjisë, Zvicrës dhe Suedisë.

IV. VLERËSIM I GJENDJES

4.1. Shqyrtim i numrave të personave të raportuar si të zhdukur

35. Gjatë viteve të kaluara, i është kushtuar shumë rëndësi mospërputhjeve në mes të numrave të raportuar të personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë. Këta numra jo vetëm që ndryshojnë por edhe janë në konflikt me njëri tjetrin dhe në një far mase kundërshtojnë njëri tjetrin. Mundësia e vlerësimit të besueshëm të personave të zhdukur është kritike për cilësimin, planifikimin e detyrave përpara dhe menaxhimin e pritjeve, përderisa numrat jo të saktë ose të pabesueshëm hapin dyert për spekulime dhe manipulime. Përcaktimi i numrit të besueshëm është prandaj qëllim me rëndësi për trajtimin e çështjes së të zhdukurve.
36. Përcaktimi i numrit të personave të zhdukur si rezultat i konflikteve të armatosura dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut është veçanërisht i vështirë, kur aktorët e shumtë grumbullojnë informacione të ndryshme për nga formati, thellësia analitike dhe për qëllime të ndryshme. Në kontekstin e konfliktit në Kosovë, padyshim se një arritje e rëndësishme është hartimi nga ICRC, *inter alia* përmes kërkesave për gjurmim nga familjet, i listës prej 6,010 individësh të cilët ishin raportuar të zhdukur ku përfshihen edhe 1,371 persona të gjetur të gjallë ose të vizituar në burgje. Sot numri i personave të cilët janë akoma të zhdukur në listën e GP është 1,862²⁰.
37. Llogaritja e të zhdukurve është problematike gjithashtu sepse listat dhe bazat e të dhënave ekzistuese dëmtohen nga vështiresitë e definimeve dhe ato konceptuale të cilat janë duke u bërë të dukshme gjithnjë e më shumë. Çfarë përbën një “person të zhdukur” varet në një masë të madhe nga konteksti i zhdukjes, kush e kërkon personin në fjalë dhe nga vendnodhja e supozuar e personit. Përderisa GP i ICRC dhe ICMP në mënyrë implicite ndajnë të njëjtën bazë për definim se kush duhet konsideruar si *i zhdukur*, përpjekjet hetuese të ICTY ishin të përqëndruara më gjerë në viktimat potenciale të krimeve të luftës. Si rezultat, EULEX trajton jo vetëm personat e raportuar si të *zhdukur*, por gjithashtu rastet e vdekjeve të lidhura me luftën në përgjithsi. Disa nga këta të dytët mund të përfshihen në mesin e mbetjeve të paidentifikuara të cilat ruhen nga EULEX, por ata mund të mos jenë të përfaqësuar në listën e GP, ose në bazën e të dhënave të ICMP. Është me rëndësi që më tej të merret parasysh se disa mbetje të cilat ruhen nga EULEX mund të mos i perkasin periudhës kohore por asaj para konfliktit.
38. Krijimi i një arkive qendrore të të dhënave për personat e zhdukur në nivel vendor – e preferueshme në një bazë të vetme të kërkueshme dhe të kompjuterizuar – do të ishte pikë e prekshme e largimit nga status quoja dhe do të mundësonte konsolidimin sistematik të të dhënave ekzistuese hetuese, të të dhënave ante mortem dhe postmortem, vendnodhjen gjeografike të vendvarrimit si dhe informatat rreth identifikimit dhe riatdhesimit. Kjo, si rezultat, do të lejonte përmirësimin e punës me raste dhe vendosjen e bazave më të mira për analiza të përgjithshme. Një arkiv i tillë qendrorë i të dhënave do të mundësonte edhe testimin e hipotezës fillestare në lidhje me përcaktimin e vendeve të varrezave massive të pazhvarrosura akoma.
39. Disa hapa në drejtim të konsolidimit dhe rishikimit të informatave në dispozicion janë bërë, veçanërisht nëpërmjet Grupit Punues të udhëhequr nga ICRC-ja. Do të ishte me rëndësi që këto të dhëna të shkëmbehen në një kohë të përshtatshme me autoritetet vendore, sikurse është GCMP, sikurse është parashikuar edhe me Projektligjin për Personat të Zhdukur. Duhet bërë dispozita gjithashtu edhe për dhënjën e të dhënave Komisionit Serb për Personat e Zhdukur. Aktualisht ICMP i ofron të dhëna të dy qeverive. Përfundimi i detyrës së krijimit të shënimeve qendrore në mënyrë transparente dhe sistematike është me rëndësi jetike për ndërtimin e kapaciteteve vendore me qëllim të mundësimit të përputhjes me detyrimet qeveritare, të përcaktuara *inter alia* ndër të tjera, në, ECHR.

²⁰ “ICRC Statistikat për Kosovën gjer në prill, 2010”; mirësjellje e ICRC.

4.2. Shqyrtimi i Procesit të Identifikimit

40. Procesi i identifikimit i udhëhequr me ADN, siç aplikohet në Kosovë, përbëhet nga përputhja e profileve të ADN-së nga mbetjet skeletore me profilet e ADN-së të anëtarëve të familjes së të zhdukurit. Prandaj mundësia e arritjes së identifikimit të bazuar në ADN varet nga zhvarrimi i sasisë së mjaftueshme të ADN-së nga mostrat skeletore dhe gjithashtu nga mbledhja e mostrave gjenetike të mjaftueshme nga të afërmit e numrit dhe llojit të mjaftueshëm për të mundësuar përputhjen e ADN-së.
41. Janë bërë përpjekje të konsiderueshme gjatë kërkimit për të zhdukurit për të rritur suksesin e përputhjes së ADN-së nga mostrat e Kosovës. Në vitin 2006, të gjitha profilet akoma të papërputhura të ADN-së ka qenë subjekt i rishqyrtimit *de novo* për të aplikuar përpunimin e analizave gjenetike të cilat janë bërë të mundshme së fundmi. Këto përpjekje kanë mundësuar një përputhje shtesë të ADN-së, dhe kanë konfirmuar të dhënat gjenetike të nxjerra më herët në të gjitha rastet tjera. Në vitin 2009 ICMP zhvilloj një metodë të re edhe më efektive të nxjerrjes së ADN-së të quajtur procesi i demineralizimit. Mëmyra e re mundëson nxjerrjen e ADN-së nga mostrat shumë të degraduara ose të pjesshme, të cilat OMPF i parashtronte në numër të madh dhe e cila përbën pothuajse të gjithë punën me ADN të ICMP të rasteve të Kosovës tani. Duke marrë parasysh se këto raste të mbetjeve janë zhvarrosur shumë kohë më parë, fatkeqesisht nuk mundë të thuhet se numri i personave të zhdukur të zhvarrosur është shtuar në asnjë masë të rëndësishme.
42. Gjer më sot, ICMP ka pranuar gjithsejt 5,918 mostra postmortem nga të dy palët OMPF dhe Serbia. Janë marrë me sukses profile të ADN-së nga 4,622 mostra, dhe puna është duke vazhduar në 37 raste të tjera. Shkalla e suksesit të përgjithshëm e nxjerrjes së profileve të ADN-së nga të gjitha mostrat e pranuar të eshtrave është 78.6%. Kjo shkallë suksesi, është më e ulët se shkalla tipike e ICMP për nxjerrjen e ADN-së nga mostrat e eshtrave gjë që reflekton parashtrimin e shumë mostrave të cilat nuk janë bërë në përputhje me Procedurat Standarde Operacionale të ICMP (PSO) për prerjen e eshtrave^{21 22}. 4,622 profilet e nxjerra të ADN-së përfaqesojnë 2,997 individë të ndryshëm që do të thotë se në shumë raste mostra të shumfishta janë parashtruar për të njëjtin individë.
43. Me qëllim të arritjes së përputhjes së ADN-së, është e domosdoshme marrja e mostrave referente gjenetike nga anëtarët e familjes së të zhdukurit. Gjer më 9 gusht 2010 ICMP ka mbledhur 14,517 mostra referente gjaku familjare, që përfaqesojnë 4,315 persona të raportuar të zhdukur nga konflikti në Kosovë. ICMP në vazhdimsi ka mbajtur ekipet për mbledhjen e mostrave në Kosovë për këtë çëllim dhe ka angazhuar edhe ekipet tjera në vende të tjera si në Serbi, B dhe H, Kroaci sikurse edhe në vendet tjera jashtë rajonit të Ballkanit Perëndimor përfshirë këtu Europën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut.
44. Gjer më 9 gusht të vitit 2010, ICMP i ka parashtruar qoftë OMPF apo autoriteteve në Serbi 3,942 raporte përputhëse të ADN-së që përfaqesojnë 2,282 individë të ndryshëm^{23 24}. Sikurse është theksuar, ka më shumë raporte përputhëse të ADN-së se individë të përfaqësuar sepse në shumë raste ICMP ka pranuar mostra të shumfishta për të njëjtin person. Zakonisht kjo është rezultat i fragmentimit ose përzjerjes së mbetjeve mortore që parashtron nevojën e përdorimit të ADN-së për të ribashkuar pjesë të mbetjeve skeletore. Megjithatë, janë bërë përpjekje thelbësore dhe bashkrendim i gjerë me OMPF për të zgjidhur rastet problematike dhe për të mundësuar identifikimin me ADN. Në disa raste përputhjet e ADN-së të cilat kanë rezultuar me identifikim kanë mundësuar përdorimin e profilit të ADN-së të personit të identifikuar si referencë shtesë familjare për personin tjetër të zhdukur të familjes dhe

²¹ Kur mostra dështon të ofrojë profilin e ADN-së, ICMP kërkon edhe një mostër për të njëjtin rast. Në shumë raste, zëvendësimi me sukses nxjerr profilin.

²² Kushtet mjedisore nga të cilat mbetjet mortore janë zhvarrosur mundë të çojnë në degradimin e ADN-së Brenda mostrave skeletore, dhe nxjerrja e sukseshme e ADN-së kërkon ekspertizë dhe protokole të rafinuara. Ruajtja e ADN-së në eshtra gjithashtu varet nga llojet e elementeve skeletore, dhe më së miri ruhet në eshtrat e denduar siç është femuri dhe dhëmbët. Në disa raste, posaçërisht me mostrat të cilat e ruajnë me më pak efektivitet ADN, ka mungesë të ADN-së për të lejuar krijimin e profilit të ADN-së. Shumë nga mostrat e pranuar nga ICMP kanë qenë nga mostrat nën optimal nga perspektiva e ruajtjes së ADN-së.

²³ Numri i përgjithshëm i raporteve individuale të *gjeneruara* të përputhjes së ADN-së gjer në 9 gusht 2010 është 2,304, përderisa numri i raporteve të *parashtruara* është 2,282; dallimi ka të bëjë me raportet të cilat janë duke u bërë gati për të ju parashtruar autoriteteve.

²⁴ ICMP në vazhdimsi njofton qeveritë pjesëmarrëse në programin e vet identifikues në Ballkanin Perëndimorë, për të gjitha raporte t e gjeneruara të ADN-së për atë rajon, s.p. Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova dhe Serbia.


rrjedhimisht kanë mundësuar edhe identifikimin e tij. Në bashkrendim me OMPF, kërkime të kohëpaskohsme janë ndërmarrë për të provuar narrëdhënjet e mundshme familjare brenda profileve të ADN-së të cilat mund të tregonin identitetin edhe në mungesë të përputhjeve të ADN-së me dhuruesit referent të mbijetuar. Ngjashëm edhe përputhjet në mes të mostrave postmortem i janë lëshuar OMPF kohë pas kohe për të mundësuar ribashkimin e rasteve të pjeshme skeletore, edhe kur përputhja me familjet nuk është gjetur.

45. Për më shumë, ICMP i lëshon OMPF listën e përputhjeve të mundshme në mes të mostrave postmortem dhe referencave familjare të cilat bien nën prapësinë statistikore prej 99.95% të sigurisë të cilën ICMP e kërkon për të lëshuar një raport përputhës të ADN-së. Këto raporte i mundësojnë OMPF të hetojnë faktet jo ADN të cilat mund të forcojnë ose zvogëlojnë mundësinë e identifikimeve të supozuara. Në rastet kur të dhënat e ADN-së së bashku me të dhënat pa ADN duken të mjaftueshme për të përkrahur identifikimin e bërë, ICMP mund të lëshojë Raportin Krahasues Statistikorë me konkluzionet e tij për rastin në fjalë. Gjer më sot janë lëshuar 67 raporte të tilla që përfaqësojnë 48 individë të ndryshëm të cilët janë identifikuar si rrjedhojë me këtë lloj çasjeje.
46. Sa i përket mbetjeve të paignifikuara njerzore të cilat akoma mbahen në morgun e OMPF, aktualisht, në bazë të vlerësimeve antropologjike të “numrit minimal të individëve” (NMI), OMPF raporton se ka akoma në ruajtje të paktën 434 individë të paignifikuar²⁵. Gjer në fund të korrikut 2010, ICMP ka nxjerrë 619 profile të ADN-së nga këto raste të pazgjidhura që përfaqësojnë 480 individë dhe 139 ribashkime në lidhje me ta. Shumica e këtyre profileve të ADN-së janë nxjerrë kohë të gjatë më parë dhe akoma kanë mbetur të papërputhura me vite (shiko figurën 1). Për 67 nga këta 480 individë ICMP ka gjetur përputhjen e ADN-së të cilët akoma janë në shqyrtim dhe në fazën e përfundimit ose të cilët tashmë janë dorëzuar; 413 profilet e ndryshme të mbetura të ADN-së nuk pëputhen me asnjë profil referent familjar. Ka edhe 160 mostra shtesë për të cilat testi i ADN-së ka dështuar në mënyrë të përsëritur për të nxjerrë profilin e ADN-së dhe për të cilët është kërkuar zëvendësimi i mostrave për testet të cilat vazhdojnë.
47. Prandaj, teorikisht, nëse profilet e ADN-së do të vendoseshin për të gjitha këto raste 160 persona të zhdukur do të identifikoheshin. Megjithatë kjo do të supozonte se mostrat e dështuara nuk do të përfshiheshin gjatë parashtrimeve të shumfishta për të njëjtin person, gjë që duket se nuk ka të ngjarë të ndodh kështu duke marrë parasysh shkallën e nivelit të lartë të parashtrimeve të shumfishta për të njëjtin person të zhdukur.

²⁵ Informata nga baza e të dhënave të ICMP e profileve të papërputhura të bazuar në statusin e NMI e azhurnuar në korrik 2010.

Figura 1: Tabela e numrave të mostrave të eshtrave nga rastet e hapura aktualisht në morgun e OMPF për të cilat ICMP ka profile të papërputhura të ADN-së në bazën e tij të të dhënave.

Tabela tregon vitin kur ICMP ka nxjerrë profilin e ADN-së. Pjesa dërmuese e 413 mostrave të papërputhura përfaqson mbetjet të cilat janë në ruajtje nga OMPF për disa vite; ngritja e lehtë e profileve të reja gjatë dy viteve të fundit përfaqson procesimin e mostrave të marra më herët por të cilat nuk i janë parashtruar ICMP nga EULEX-i.



48. Në periudhën janar 2009 gjer me 9 gusht 2010, ICMP ka pranuar 1,063 mostra postmortem nga OMPF. Sikurse u theksua më herët, parashtrimi i këtyre mostrave demonstroi përpjekjet e theksuara të OMPF për të rishqyrtuar rastet në morgun e Prishtinës, përfshirë këtu edhe mostrat e marra më herët por të cilat nuk i ishin parashtruar ICMP-së. Nga 1,063 mostra të parashtruara 520 ishin nga mbetjet e zhvarrosura në Kosovë në një kohë dhe 543 ishin nga mbetjet e zhvarrosura në Serbi në vitin 2001 dhe 2002.²⁶ Nga 1,063 mostra, profili i ADN-së është nxjerrë për 689 nga to, puna është duke vazhduar në 34 dhe nga 340 nuk është nxjerrë ADN e mjaftueshme për të mundësuar prodhimin e profilit. Nga 689 profile të nxjerra, 485 paraqesin individë mostrat e të cilëve ishin parashtruar më herët dhe profilet e ADN-së ishin nxjerre.
49. Prandaj, efekti kryesor i testeve të ADN-së që nga viti 2009 ishte ribashkimi i mbetjeve të pjeshme skeletore të mbetjeve të identifikuar me anë të ADN-së më parë. Ka 485 ribashkime të tilla me ADN. Pa vazhduar testimet konfirmuese (shif më poshtë), niveli me të cilin mostrat postmortem janë pranuar që nga janari 2009 dhe që ka të bëjë me personat e zhdukur të cilët akoma nuk janë gjetur dhe profiluar me ADN ka rënë në përgjithësi në 4.68%.
50. Shkalla e ulët e identifikimeve të reja përbën shqetësim të madh. Në Raportin e Vlerësimit të Gjendjes²⁷ të ICMP nga viti 2005 është sugjeruar se gjer në mars të vitit 2005, ICMP ka lëshuar 2,066 Raporte përrputhëse të ADN-së që përfaqsojnë 1,363 individë. Me më shumë rëndësi, Raporti thekson se ICMP kishte pranuar mostrat postmortem të cilat do të mundësonin llogaritjen e 2,500 individëve të zhdukur gjithsejt.


²⁶ Fillimisht ICMP ndërmori testimet e ADN-së në shkallë të gjerë nga mostrat e zhvarrosura në Serbi, të cilat u parashtruan nga autoritetet serbe para vitit 2006. Për këto mostra, ICMP lëshoi 920 raporte përputhëse të ADN-së për 780 individë. Megjithatë ICMP ka mostra unike shtesë të papërputhura nga 23 raste të mostrave të parashtruara nga OMPF në periudhën janar 2009 gusht 2010.

²⁷ *Situata në Kosovë: Vlerësimi i Gjendjes*, ICMP.FSD.18.05.doc.

51. Sot, ICMP mund të llogarisë në gjithsejt 2,997 persona bazuar në mostrat e pranuar nga të cilët 2,304 janë identifikuar përmes ADN-së. Megjithatë nga 2997 individët për të cilët ekzistojnë informatat gjenetike, mostrat postmortem për vetëm 521 individë (17.4%) i janë parashtruar ICMP për pesë vjetë e gjysëm që nga marsi i vitit 2005 (shif figurën 2).

Figura 2: Profilet unike të nxjerra nga mostrat postmortem të pranuar nga viti 2002 gjer 2010.

Kjo tabelë pasqyron vitet kur mostrat i janë parashtruar ICMP-së dhe demonstroi rënjen e numrit të mostrave në nivel vjetor që nga viti 2005, që tregon rënien e theksuar të numrit të mjetëve mortore të zhvarrosura nga varrezat klandestine.²⁸



52. Aktualisht, ICMP ka një pjesë të madhe të mostrave të papërputhura të gjakut të cilat mund të ofrojnë referenca të mjaftueshme të mostrave për të mundësuar arritjen e 1,800 përputhjeve gjentike, megjithatë sikurse theksohet më lartë, asnjë nga 413²⁹ rastet në morgun e Prishtinës nuk përputhet me këto mostra, madje as në një shkallë të sigurisë më të ulët se 99.95%.
53. Duke marrë parasysh se nga mbetjet e paidentifikuara në ruajtje të OMPF jnaë marrë mostra në mënyrë ekstensive për të nxjerrë profilet e ADN-së, dhe se profilet janë nxjerrë për pjesën dërmuese të këtyre rasteve, është e udhës të vijmë në përfundim se vazhdimi me qasjen e tanishme nuk ofron asnjë perspektivë për zgjidhjen e një numri të madh të rasteve të personave të zhdukur të cilët aktualisht janë akoma të hapur në listën e GP. Përparimi dukshëm i munguar në arritjen e identifikimeve të reja gjatë viteve të fundit është pasqyruar hollsisht në figurën 3.
54. ICMP ka 14,517 profile referente familjare që përfaqsojnë 4,315 persona të zhdukur. Nga këta 4,315 persona të zhdukur 2,304 janë identifikuar përmes ADN-së. ICMP me besueshmëri vlerëson se është në posedim të referencave të mjaftueshme familjare për të mundësuar përputhjen e ADN-së për ~1,800 (ose 90%) nga 2,011 personat akoma të zhdukur nga të cilët 1,549 janë gjithashtu në listën e GP nga gjithsejt 1,862. Në përgjithsi, ICMP ka referenca të mjaftueshme familjare për të mundësuar përputhjen e ADN-së për më shumë se 95% nga 4,315 persona të zhdukur të raportuar tek ICMP.
55. Këto shifra duket se sugjerojnë se, teorikisht, mungesa e referencave familjare mund të luaj rol në vetëm 313 raste akoma të pazgjidhura në listën e GP. Megjithatë, për shumë prej këtyre rasteve ku nuk është e sigurtë se referencat ekzistuese do të mundësonin përputhjen, një sugjerim i fortë i identitetit mund të jetë pak a shumë evident për të lëshuar raporte statistikore krahasuese të ADN-së. Për rastet


²⁸Rritja e lehtë në vitin 2009 pasqyron përpunimin e mostrave të cilat ishin marrë më herët por të cilat nuk i ishin parashtruar ICMP. Shif paragrafet 28 dhe 29.

²⁹ Shif paragrafin 45 për detaje.

tjera të mbetura, me përjashtim të rreth 50 rasteve, nuk kanë mbetur rrugë tjera për mbledhjen e mostrave të gjakut. Fatkeqsishtë, përpjekjet shtesë për mbledhjen e gjakut, nëse ato do të ndërmerren, nuk janë premtuese për zgjidhjen e shumë rasteve shtesë.

Figura 3: Rezultatet e identifikimit të mostrave të pranuar postmortem, sipas vitit kur I janë parashtruar ICMP-së.

Shenja blu tregon numrin e përgjithshëm të mostrave të pranuar, shenja e kuqe tregon numrin e këtyre mostrave të cilat kanë dhënë profilin e ADN-së dhe shenja e gjelbër tregon numrin e atyre që kanë rezultuar me identifikime të reja.



56. Përveç kësaj ka 693³⁰ profile unike të ADN-së të marra nga grupe të mbetjeve mortore të cilat nuk kanë përputhje korresponduese me asnjë nga 14,517 referenca familjare të mbledhura nga ICMP. Ky kombinim i 693 profile të papërputhura të ADN-së së eshtrave në njërin anë dhe 2,011 persona akoma të zhdukur në anën tjetër përbënë vështërsinë kryesore të situatës së personave të zhdukur në Kosovë³¹ Për arsye të përmendura më lartë, vazhdimi me qasjen e tanishme mundë të rezultojë vetëm me identifikimin e një numri të vogël të personave të zhdukur. Perparimi i tillë do të dështonte thelbësisht të korigjonte numrin e profileve të papërputhura të ADN-së të marra nga mbetjet skeletore dhe referencat familjare të ADN-së në anën tjetër.

57. Është e dobishme që këto shifra të vendosen në perspektivë sepse ka ngjashmëri të theksuara të problemit të personave të zhdukur në Kosovë me atë të vendeve të rajonit e në veçanti me B dhe H. Qëkur Kosova mori pjesë plotësisht në sistemin e udhëhequr nga ADN-ja, shumë tregues ishin të ngjashëm me ata në B dhe H nëse merret parasysh përqindja e personave të raportuar të zhdukur në

³⁰ ICMP ka 4,622 profile të ADN-së nga mbetjet njerzore në bazën e tij të të dhënave për Kosovë që përfaqsojnë 2,997 individë të ndryshëm. Gjer me 9 gusht, 2010, 2,304 nga këta individë janë përputhur me familjet duke lënë 693 profile unike të ADN-së të personave të ndryshëm pa përputhje.

³¹ Shif figurën 1, Annex 1, e cila përbën përmbledhjen e të dhënave kyçe statistikore.

secilën rrethanë. Këta tregues krahasimorë përfshijnë: përqindjen e personave të zhdukur për të cilët janë mbledhur mostrat referente, përqindjen e personave të zhdukur të cilët janë zhvarrosur dhe kanë profil të ADN-së si dhe përqindjen e personave të zhdukur të identifikuar gjer më sot.

58. Megjithatë, ka një dallim të rëndësishëm i cili kërkon vëmendje të posaçme gjatë hartimit të strategjisë së re për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur në Kosovë. Autoritetet qeveritare në B dhe H kanë vlerësuar se rreth 7,000 persona të cilët u zhdukën si pasojë e luftës në B dhe H janë identifikuar gjatë dhe menjëherë pas përfundimit të armiqsive para prezantimit të sistemit të udhëhequr nga ADN-ja. Numri i raportuar në Kosovë duket të jetë së paku 2,000³². Në lidhje me numrat e përgjithshëm rrespektivë të personave të zhdukur, kjo përbën përqindje dukshëm më të madhe të individëve mbetjet mortore të të cilëve janë identifikuar pa mjete të besueshme se sa ishte rasti në B dhe H.

4.3. Vlerësimi i identifikimeve të gabuara

59. Në Kosovë gabimet në identifikime të bëra para përdorimit sistematik të ADN-së, mund ti kontribuojnë mospërputhjes së vërejtur në mes të numrave të atyre të cilët akoma janë të raportuar si të zhdukur, numrit të papërputhur të referencave të gjakut dhe numrit të papërputhur të profileve të ADN-së. Disa nga referencat e papërputhura familjare për personin e raportuar të zhdukur mund të mos përputhen asnjëherë sepse trupi i personit të zhdukur i është kthyer gabimisht një familjeje tjetër. Si rrjedhojë, familja e cila e ka pranuar trupin e gabuar mund të mos ketë dhënë mostrat referente duke supozuar se kërkimi i tyre ka mbaruar duke shkaktuar kështu mospërputhjen e mbetjeve të zhvarrosura të anëtarit të vërtetë të familjes së tyre.
60. Përvoja e ICMP në tërë Ballkanin Perëndimor ka treguar se identifikimi tradicional bart në vete rrezik thelbësorë për gabime. Në Kosovë, niveli i gabimeve nuk është ekzaminuar sistematikisht, por hetimet fillestare duke përdorur ADN për të testuar identifikimet e mëhershme pa ADN tregojnë se ky problem duhet të shqyrtohet hollsishtë.
61. Me kërkesë të familjeve OMPF ka hetuar disa identifikime të bëra më herët, ku mbetjet janë zhvarrosur dhe mostrat janë marrë, kurse familjet kanë dhënë mostrat referente për konfirmim me ADN nga ICMP. Në 77 raste të tilla të papërfunduara ku ICMP ka qenë në gjendje të gjurmtojë, 13 prej tyre janë treguar si identifikime të gabuara të bëra me metodë tradicionale që do të thote se trupi i identifikuar më herët nuk kishte marrëdhënie familjare me familjen në fjalë. Për më tepër testet e ADN-së kanë treguar një nivel më të lartë të përjashtimeve (mesatarisht 30%) në rastet kur OMPF ka parashtruar mostrat së bashku me identitetin e supozuar të mbetjeve skeletore. Duhet të qartësohet se a janë rastet e hetuara gjer tani përfaqesuese apo jo për 2,000 rastet e identifikuar pa ADN në përgjithsi. Qasja sistematike për të kuptuar madhësinë dhe implikimet e gabimeve të mëhershme të identifikimeve është kritike për të kuptuar situatën e personave të zhdukur në Kosovë në përgjithsi dhe në definimin e një strategjie optimale për arritjen e identifikimeve shtesë.
62. Një aspekt që bie në sy në lidhje me rezultatet e identifikimeve me ADN në Kosovë është dispariteti i shkallës së përputhjeve në mes të mostrave të zhvarrosur në Kosovë dhe atyre të zhvarrosura nga varrezat massive në Serbi ku ato ishin subjekt i një marrjeje uniforme të mostrave të ADN në një çasje tërësishtë të udhëhequr nga ADN-ja dhe pa asnjë trup të identifikuar me metoda tradicionale³³. Niveli i përputhjes së profileve të mbetjeve të zhvarrosura në Serbi është 97.2%, dhe për dallim prej kësajë profilet e zhvarrosura në Kosovë kanë një shkallë përputhëse prej vetëm 68.9%³⁴.
63. Është e paqartë arsyeja e këtyre dallimeve. Personat e zhdukur të zhvarrosur në Kosovë janë të prekur nga një shkallë e lartë e identifikimeve të gabuara. Megjithatë, mund të ndodhë që individët e

³² Shif fusnotën 15.

³³ ICMP u ftua nga Qeveria e Serbisë për të ndihmuar në zhvarrimin arkeologjik mjekoligjor të këtyre mbetjeve të gjetura në Batajnicë, Petrovo Selo dhe Bajna Bahsta. Për më shumë informata rreth gërmimeve të vendvarrimeve në vitin 2001 dhe 2002, shif; <http://www.icmp.org/wp-content/uploads/2008/02/batajnica-2001-alb.pdf> - Ekshumimet në Serbi, 2001 Përmbledhje; <http://www.icmp.org/wp-content/uploads/2008/02/icmp-fsd-16-04-2-alb-doc.pdf> - Raporti Përmbledhës i Monitorimeve të Aktiviteteve Mjekoligjore në Batajnicë.

³⁴ Shif Figurat 2a dhe 2b, Annex 1.

zhvarrosur në Serbi të jenë persona të zhdukur ekskluzivisht si rezultat i zhdukjeve të dhunshme gjatë konfliktit, kurse mbetjet e zhvarrosura në Kosovë mundë të përfshijnë raste të cilat nuk kanë të bëjnë me konfliktin. Jopariteti i përputhjes së ADN-së në mes të këtyre dy grupeve të personave të zhdukur mundë të qartësohet vetëm me vlerësimin sistematik të çështjes së identifikimeve të gabuara të mëhershme sikurse u diskutua më lartë dhe përmes një auditimi të vërtetë të përgjithshëm të mbetjeve të zhvarrosura në Kosovë dhe mënyrë se si janë mbyllur rastet.

V. KONKLuzionET

64. Gjer më sot janë ndërmarrë disa iniciativa për të shqyrtuar progresin e arritur. Së fundmi ICMP në vitin 2009 propozoi shqyrtimin e përbashkët strategjik për të analizuar së bashku me aktorët ndërkombëtarë, në veçanti EULEX-OMPF dhe me qëllim të përfshirjes së vendimarrësve vendorë. Nga ana e tijë OMPF ndërmori shqyrtimin e të dhënave dhe bazuar në kërkesat e familjeve të shqetësuara parashtrorë ICMP-së për ekzaminim pjesë të punës në identifikime në të kaluarën. Gjithashtu i parashtrorë edhe mostra të marra më parë por të cilat nuk i ishin parashtruar ICMP.
65. Autoritetet vendore në Kosovë kanë treguar një interes dukshëm në rritje të demonstrimit të llogaridhënjës rreth çështjes në mënyrë të tillë e cila ju jep besueshmëri shqetsimeve të tyre dhe që forcon kredibilitetin tek popullata e Kosovës. Iniciativat e kohës së fundit të ndërmarra nga qeveria e Kosovës, siç ishte krijimi i Grupit të Politikave përfshijnë fuçizimin e kapaciteteve të GCMP, hartimin e ligjit për persona të zhdukur dhe bashkrendimin e qasjes strategjike për të trajtuar problemet teknike, përfshirë edhe identifikimet e gabuara të cilat po paraqesin pengesë për progres. Këto nisma duhet shikuar si të favorshme.
66. Krijimi i arkivit qendror të të dhënave për personat e zhdukur është domosdoshmëri, e cila është pranuar nga qeveria që nga viti 2006, do të ishte pika e prekshme e nisjes për konsolidimin sistematik të të dhënave ekzistuese hetimore, antemortem dhe postmortem, informatat rreth vendit të vendzarrimeve si dhe të dhënat e identifikimit dhe riatdhesimit, të cilat do të mundësonin përmirësimin e punës me raste dhe do të vendosnin baza më të mira për analiza të përgjithshme.
67. Mungesa e vazhdueshme e proceseve vendore nënkupton gjithashtu edhe mungesën e përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve për këto procese. Në vete kjo ka të ngjarë të ketë ndikim afatgjatë sepse aktorët ndërkombëtarë nuk mundë të shpresojnë zgjidhjen gjithpërfshirëse të problemit të personave të zhdukur përmes punës së vazhdueshme me raste dhe as nuk mund të jenë në vazhdimësi zëvendësim i përgjegjësive vendore. Për më tepër, mungesa e pjesmarrjes vendore parandalon zhvillimin e ndjenjës së pronësisë së sukseseve dhe pengesave gjithashtu. Rishqyrtimi i kësajë situate në Kosovë është po aq i rëndësishëm për perspektiven e punës me raste në të ardhme sa edhe për përcaktimin se a do të konsiderohen në të ardhmen përpjekjet ndërkombëtare të suksesshme apo jo.
68. Përgjegjësia vendore dhe përparimi në punën me raste janë shqetësime të ndërlidhura. EULEX sot ballafaqohet jo vetëm me rastet e personave të raportuar si të zhdukur, por me shumë mundësi edhe me humbjet e lidhura me luftën gjithashtu. Zhvillimi i një baze më të gjerë konceptuale e cila do të pranohej në nivel vendor do të kërkojë përfshirjen e autoriteteve vendore të Kosovës, institucionet dhe familjet e të zhdukurve gjë që mund të sjellë mbledhjen e referencave familjare për humbjet e shkaktuara nga lufta në përgjithësi në një përpjekje për të zgjidhur rastet në ruajtje të OMPF të cilat nuk korrespondojnë me personat e raportuar të zhdukur tek GP.
69. Përveç kësaj, EULEX ka trashëguar punën identifikuese e cila me shumë gjasa përfshinë një numër të konsiderueshëm të gabimeve. Trajtimi gjithpërfshirës i këtyre gabimeve do të kërkojë rihvarrime dhe ripërtëritje të mbledhjes së mostrave referente nga familjet të cilat më herët kanë pranuar trupa të identifikuar me metoda tradicionale, dhe një strategji e tillë duhet të peshojë implikimet sociale, ligjore, financiare dhe politike përkundrejt rezultateve të pritshme.

70. Ka arsye, përtej mangësive në definim dhe identifikimet e gabuara në të kaluarën kanë çuar në rrugë pa krye. Këto arsye përfshijnë problemet edhe me listat vetvetiu. Është akoma e paqartë nëse të gjitha rastet e raportuara janë akoma të hapura ose nëse familjet kanë pranuar identifikimet, ose varrosur të dashurit e tyre dhe për këtë gjë nuk e kanë vënë në dijeni GP.
71. Prandaj puna më e madhe me shoqërinë në terren, mundësimi i përgjegjesisë vendore, zhvillimi i një baze më të gjerë konceptuale për atë se kush duhet konsideruar "i zhdukur", trajtimi i trashëgimisë së punës identifikuese e cila me shumë gjasë përfshin një numër të rëndësishëm gabimesh, ritrajtimi i problemeve me listat aktuale dhe sigurimi i bashkëpunimit më të mire vendor dhe ndërkombëtar duhet të jenë elementet kyç të një strategjie në të ardhmen, për të ecur përpara.

VI. REKOMANDIMET

6.1. Shqyrtimi i Përbashkët

72. ICMP dhe EULEX duhet të ndërmarrin shqyrtimin e përbashkët për të ekzaminuar të dhënat e zhvarrimeve, raportet e autopsive, qertifikatat e vdekjes, çfarëdo raporti mbi vlerësimin e gjendjes të ndërmarrë nga EULEX-OMPF, si dhe çfarëdo të dhënash tjera të rasteve të mbyllura. Shkalla e besueshme e gabimeve për identifikimet e mëhershme pa ADN mund të përcaktohet përmes shqyrtimit të rasteve të veçanta ose grupeve të identifikimeve të mëhershme me anë të kriterëve objektive. Një nëngrup i këtyre rasteve mund të përfshijë familjet të cilat tashmë kanë dhënë mostrat referente të ADN-së tek ICMP dhe kanë varrosur të afërmit e tyre bazuar në identifikimet me ADN si dhe të afërmit e identifikuar me metoda tradicionale. Shqyrtimi i rasteve të tilla, përfshirë edhe të dhënat e identifikimeve të mëhershme, mund të jetë me vlerë të veçantë për vlerësimin objektiv të shkallës së gabimeve në lidhje me identifikuesit të cilët janë përdorur në punën identifikuese pa ADN. Hetimi i këtyre rasteve me anë të rishvarrimeve nuk do të sillte nevojën e mbledhjes së mostrave të reja referente, por do të kërkonte bashkëpunimin e anëtarëve të familjes mostrat referente të të cilëve janë profiluar me ADN tashmë dhe të cilët janë familjarizuar me procesin e identifikimit me ADN.
73. Zhvillimi apo jo i kësaj qasjeje varet nga hartimi i strategjisë e cila merr parasysh shpenzimet, premtot rezultate të dobishme dhe e cila ka vlerësuar ndikimin e duhur shoqëror të rihapjes së rasteve duke parshikuar këtu edhe përfshirjen e autoriteteve vendore dhe shoqatave familjare. Si rezultat me siguri se do të ketë përparim në punën me raste. E rëndësishme është që përcaktimi i shkallës së besueshme të gabimeve përgjatë spektrit të identifikuesve do të lejonte vendimarrësit dhe autoritetet lokale për tu informuar më mirë, në të dy aspektet në lidhje me madhsinë e problemit në Kosovë dhe mundësisht edhe për ekzistimin e varrezave të tjera klandestine brenda dhe jashtë Kosovës.
74. Rezultatet e këtyre përpjekjeve të përbashkëta duhet ti dorëzohen qeverisë së Kosovës sipas kërkesës së Grupit të Politikave³⁵ dhe qeverisë së Serbisë dhe duhet të shkëmbehen me familjet e personave të zhdukur në mënyrë që ata të angazhohen në hapat e mëtutjeshëm se si duhet trajtuar çështja.

6.2. Grupi i Politikave

75. Ndërtimi i kapaciteteve vendore është i rëndësishëm për ti mundësuar qeverisë për të përmbushur detyrimet e saj të drejtave të njeriut mbi çështjen e personave të zhdukur. Serbia aktualisht ka një komision të kalitur që punon mbi këtë çështje. Është e rëndësishme që institucionet e Kosovës të jenë të afta që të angazhohen në këtë proces në një mënyrë proporcionale dhe të qëndrueshme. Prandaj, duhet të sigurohet mbështetje për iniciativën e Qeverisë së Kosovës për të vazhduar me Grupin e saj të Politikave në mënyrë që të sigurohet një qasje strategjike për këtë çështje. Kjo do të lejojë GCMP të Kosovës për të siguruar familjet e të pagjeturve me informacion të besueshëm dhe të saktë në të gjitha

³⁵ Shif paragrafin 31.

përpjekjet në vazhdim për të përcaktuar fatin e të zhdukurve. Kjo duhet të përfshijë informacione për problemet teknike që janë një pengesë për progres në përgjegjësinë për personat e zhdukur.

6.3. Arkivi Qendror i të Dhenave

76. Shqyrtimi i përbashkët gjithëpërfshirës do të ishte pikë e prekshme e nisjes për konsolidimin sistematik të të dhënave ekzistuese hetimore, antemortem dhe postmortem, informatat rreth vendit të vendzarrimeve si dhe të dhënat e identifikimit dhe riatdhesimit, të cilat do të mundësonin përmirësimin e punës me raste dhe do të vendosnin baza më të mira për analiza të përgjithshme. ICMP ju ka thënë autoriteteve të Kosovës, që do vinte në dispozicion sistemin e menaxhimit të tij të të dhënave mjekoligjore për këtë qëllim. Duhet gjithashtu hartuar dispozita me të cilat edhe Komisionit Serb për Persona të Zhdukur do ti ipeshin këto të dhëna.

6.4. Ligji i Kosovës për Personat e Zhdukur

77. Ligji për Persona të Zhdukur duhet të qartësojë mandatin e GCMP si agjenci e pavarur qeveritare me autoritetin për të bashkëpunuar çështjen e personave të zhdukur në lidhje me konfliktin në Kosovë me aktorët relevantë vendorë dhe ndërkombëtare, dhe subjektet e tjera qeveritare, përfshirë këtu edhe sistemin gjyqësor. Ligji për Persona të Zhdukur duhet shprehimisht të theksojë autoritetin e GCMP-së për monitorimin dhe bashkëpunimin e procesit të gjurmimit që lidhen me rastet e personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë dhe për të siguruar transparencë dhe mosdiskriminim. Për më tepër, Ligji për Persona të Zhdukur duhet të jetë katalizator për krijimin e Arkivit Qendror të të Dhënave.

6.5. Komisioni i Qeverisë së Kosovës për Persona të Zhdukur

78. Iniciativat e fundit të qeverisë së Kosovës për të fuqizuar kapacitetet e GCMP, dhe për të bashkëpunuar punën me raste duhet të përkrahen. Kalimi i autoritetit të çështjes së personave të zhdukur tek autoritetet vendore duhet qartazi të sigurojë se autoritetet vendore do të përmbushin obligimet e veta në mënyrë jodiskriminuese, transparente dhe llogaridhënëse.

6.6. Angazhimi i Shtuar i Familjeve të Personave të Zhdukur

79. Pasi të arrihet një marrëveshje me EULEX-in për t'u angazhuar në një shqyrtim të përbashkët dhe për të krijuar një strategji të përbashkët, kjo strategji duhet të shkëmbehet me Grupin e Politikave, si dhe me Komisionin Serb dhe familjarët e të zhdukurve. Në këtë drejtim, duhet thirrur një takim i veçantë nikoqir i të cilit do të ishin familjarët e të zhdukurve dhe i cili do të përkahej nga ICMP dhe EULEX-i për të vazhduar me konferencën e Ohrit të organizuar nga ICMP në vitin 2007³⁶.

³⁶ Shif konkluzionet e Konferencës së Ohrit të ICMP të vitit 2007: <http://www.ic-mp.org/wp-content/uploads/2008/03/icmp-csi-18-2-doc.pdf>.

Annex 1: FIGURAT

Tabela 1: Përmbledhje e të dhënave kyçe statistikore, përfshirë statistikat në lidhje me procesin e identifikimit të udhëhequr nga ADN të ICMP për Kosovë gjer më 9 gusht 2010.

Këto të dhëna nënvizojnë vështërsitë thelbësore të statusit aktual të personave të zhdukur në Kosovë: pothuajse 2000 individë janë akoma të raportuar të zhdukur tek Grupi Punues i ICRC (GP) për të cilët mbledhja e referencave familjare të ADN-së është pothuajse e përfunduar virtualisht, numrë I madh I personave të zhdukur për të cilat profilet e referencave familjare të ADN-së ekzistojnë por të cilat nuk përputhen me asnjë profil të ADN-së, dhe 693 profile të ADN-së të cilat nuk përputhen me asnjë mostër referente. Ka më shumë profile të ADN-së sesa individë të përfaqësuar me profile të ADN-së për arsye të parashtrimit të shumëfishtë të mostrave për të njëjtin individë.

*Rastet “e pahapura” tek ICMP janë ato për të cilat ICMP nuk ka mbledhur mostra referente familjare.

STATUSI I MOSTRAVE REFERENTE TË GJAKUT TEK ICMP	
Personat e raportuar të zhdukur tek ICMP me referenca familjare të gjakut	4315
Totali i profileve referente të gjakut tek ICMP	14517
Personat e Zhdukur me përputhje të ADN-së nga ICMP	2304
Numri i mostrave të parashtruara tek ICMP	5918
Numri i raporteve përputhëse të ADN-së të parashtruar nga ICMP	3942
Personat e raportuar të zhdukur të cilët nuk kanë përputhje tek ICMP	2011

STATUSI I MOSTRAVE POSTMORTEM (PM) TEK ICMP	
Profilet e krijuara PM të ADN-së	4622
Nga mbetjet e zhvarrosura në Kosovë	3153
Nga mbetjet e zhvarrosura në Serbi	1469
Individët unik të përfaqësuar me PM profile të ADN-së	2997
Nga mbetjet e zhvarrosura në Kosovë	2157
Nga mbetjet e zhvarrosura në Serbi	840
Individët për të cilët përputhjet e PM të ADN-së janë raportuar	2304
Nga mbetjet e zhvarrosura në Kosovë	1487
Nga mbetjet e zhvarrosura në Serbi	817
Profilet unike PM të ADN-së të mbetura të papërputhura	693

STATUSI I LISTËS SË GRUPEVE PUNUESE (GP)	
Personat akoma të zhdukur në listën e GP	1862
Personat e zhdukur të regjistruar tek ICMP nga lista e GP	1802
Për të cilët ICMP ka referenca të plota familjare të gjakut	1549
Për të cilët ICMP ka referenca të pjeshme familjare të mostrave gjakut	253
Për të cilët nuk ka rast të hapur tek ICMP****(Shif sqarimin më poshtë)	60
Për të cilët ICMP ka referenca të mjaftueshme familjare të mostrave të gjakut për të arritur përputhjen e mundshme	187
Për të cilët përputhja e mundshme e ADN-së ekziston (Raporti në shqyrtim)	77
Për të cilët nuk ekzistojnë mostrat e përshtatshme referente familjare të gjakut	66
Për të cilët familjet kanë refuzuar të dhurojnë mostrën referente të gjakut	5
Për të cilët nuk ekzistojnë dhurues shtesë të mostrave referente të gjakut	52
Për të cilët duhen informata shtesë rreth dhuruesve	7
Për të cilët mbledhja e mostrave referente familjare të gjakut është duke vazhduar nga ICMP	2
Shënim:	
Për të cilët nuk ka rast të hapur tek ICMP****	
Për të cilët familjet kanë refuzuar të dhurojnë mostrat referente të gjakut	15
Për të cilët nuk ekzistojnë dhurues shtesë të mostrave referente familjare të gjakut	8
Për të cilët duhen informata shtesë rreth dhuruesve	32
Për të cilët mbledhja e mostrave referente familjare të gjakut është duke vazhduar nga ICMP	5

Figura 2a dhe 2b: Tabela krahasuese e shkallës së përputhjes së profileve të ADN-së me referencat familjare (s.p., shkalla e identifikimit).

a) e individëve të zhvarrosur në territorin e Serbisë (97.2 % shkalla e përputhjes), b) e individëve të zhvarrosur në territorin e Kosovës (68.9%), c) tabela e përgjithsme e 76.7%.



Annex 2: FJALORI

Termat në fjalor janë radhitur sipas alfabetit dhe nuk reflektojnë radhitjen në gjuhën Angleze.

A.

Antemortem (AM) - të dhënat: I referohen informatave dhe dokumentacionit për personin e zhdukur para vdekjes. Kjo mund të përfshijë informatat rreth: gjinisë, moshës, gjatsisë, peshës, ngjyrën e flokëve të dhënat dentare dhe mjeksore.

ADN (AcidiDezoksiriboNukleik): Substanca e cila mban informatat gjenetike (trashëguese) dhe e cila është e pranishme në bërthamën e qelizës e pothuajse të gjitha organizmave të gjallë.

Analiza e afërsisë (gjenetike): Përcaktimi i afërsisë së mundshme të individëve bazuar në trajtat e tyre të përbashkëta gjenetike të cilat bëhen të ditura përmes testimit të ADN-së. Probabiliteti i afërsisë mund të llogaritet matematikisht, dhe kjo përdoret si bazë për përputhjen e ADN-së në mes të mbetjeve të paidentifikuara njerëzore dhe anëtarëve të familjes së të zhdukurve.

E.

Ekstrahimi i ADN-së Demineralizimi: Proces kimik i pasurimit të ADN-së nga mostrat e eshtrave në formë pluhuri, përfshirë edhe shkrirjen e tërësishme të mineraleve dhe bërthamës së proteinëve të kockës. Kjo mënyrë është veçanërisht e efektshme me mostrat e vjetra dhe të degraduara. Që nga qershori i vitit 2009, të gjitha mostrat e eshtrave nga Kosova i nënshtrohen metodologjisë së demineralizimit.

G.

Gërmimet: Gërmimi i mbetjeve të vorrosura njerëzore nga varrezat klandestine, të vetme, shumëfishe apo varreza masive. Praktikant më të mira mjekoligjore sugjerojnë që kjo të bëhet nga arkeologë ose/dhe antropologë të kualifikuar, të cilët përveç marrjes së të dhënave dhe zhvarrimit të mbetjeve njerëzore dhe fakteve përcjellëse, mund të ndërmarrin dhe dokumentojnë ekzaminim të detajuar të mjedisit rrethues. Kjo mund të përfshijë shënimin dhe zhvarrimin e fakteve gjeologjike, ekofaktuale ose artefakteve të cilat kanë të bëjnë me vendvarrezën, përbërjen e varrezës dhe konstruksionin e sajë.

I.

Identifikimi me metoda tradicionale: Identifikimi i ndërmarrë në mungesë të informative të ADN-së. Kjo mund të bazohet në identifikuesit parësorë si: gjurmët e gishtërinjve, radiografija dentare apo skeletore, ose kushtet e veçanta mjeksore ose protezat e përhershme; ose kohë pas kohe bazohet më shumë në kriteret subjektive si: njohja vizuale e mbetjeve ose gjësendeve personale, krahasimi i përgjishëm i profilit biologjik si dhe informatat rrethore.

M.

Mostra biologjike: Shif Mostrat e ADN-së.

Mostra Gjenetike: Shif Mostra e ADN-së.

Mostra e gjakut: Shif Mostrat e ADN-së.

Mostra e ashtit: Shif Mostrat e ADN-së.

Mostrat Postmortem: Shif mostrat e ADN-së.

Mostra referente: Shif mostrat e ADN-së.

Mostrat referente Familjare: Shif Mostra e ADN-së.

Mostrat e ADN-së:

- **Mostra e ashtit:** Mostra fizike e marrë nga indi skeletor (kocka apo dhëmbi) i personit të zhdukur gjatë ekzaminimit postmortem për qëllim të analizës së ADN-së. ICMP ofron Procedura Standarde Operacionale (PSO) të detajuara për mostrimin e eshtrave;
- **Mostra referente e gjakut:** Mostra e gjakut e marrë nga ICMP nga anëtarët e familjes së personit të zhdukur me qëllim të analizës së ADN-së, që pasohet nga përputhja gjentike me profilet e ADN-së nga mbetjet e pidentifikuara njerzore. Në shumicën e rasteve disa mostra janë të nevojshme për të arritur përputhjen.

N.

Numri Minimal i Individëve (NMI): Numri Minimal i Individëve i përfaqësuar në grumbullin e mbetjeve skeletore. Në termat antropologjike, aplikohet zakonisht kur bëhet zbulimi i një numri të shpërndarë të mbetjeve skeletore, dhe paraqet numrin e supoyuar minimal të individëve të përfaqësuar me element skeletor në grumbull. Mundë të përdoret në kontekstin e ADN-së për të përfaqësuar numrin e individëve në grumbullin skeletorë me numrin e provileve unike të nxjerra të ADN-së. Metodrat e ndryshme të vlerësimit të NMI mundë të japin rezultate të ndryshme.

P.

Profilat Biologjike: Profili biologjik paraqet një sër veçorish të cilat një individ i posedon gjatë jetës, të përcaktuara nga analizat e mbetjeve njerzore pas vdekjes. Këto veçori përbëhen nga: gjinia, mosha biologjike në vdekje, statura, informatat gjeografike, traumat dhe/ose kushtet tjera mjeksore gjatë jetës. Analiza e këtyre veçorive ndërmerret me krahasimin e drejtpërdrejtë të mbetjeve me ekzemplarët standard të pranuar fizik apo grafik, ose me aplikimin e modeleve matematikore të zhvilluara për popullatën referenteons.

Profili Gjenetik: Shif Profili i ADN-së.

Profili i ADN-së: Lista e karakteristikave të ADN-së së një individi në një numër të ndryshëm të lokacioneve (lokus) të zgjedhura të ADN-së, duke ju përmbajtur nomenklaturës së pranuar. Në ICMP profilet gjenetike në përgjithsi kanë të bëjnë me lokusin e 15 nuklear të Përsëritjes së Vargjeve të Shkurtra (PVSH) të cilat janë shumë të veçanta për individin duke shtuar edhe lokusin që tregon gjininë.

Profili Unik: Profili i dallueshëm i ADN-së i cili përfaqësonë ndividë të vetëm. Në mbledhjen e profileve të ADN-së të nxjerrë nga mostra të ndryshme eshtrash, individi i veçantë mundë të përfaqësohet disa herë; numri i “profileve unike” tregon numrin e individëve të ndryshëm të përfaqësuar me profilet e ADN-së në fjalë.

Procesi i Identifikimit i udhëhequr nga ADN-ja: Një Proces në të cilin ADN-ja përdoret si mjet kryesorë për të identifikuar personat e zhdukur bazuar në përputhjen e “verbër” në mes të profileve të ADN-së të personit të zhdukur dhe profileve referente të ADN-së, ku nuk kërkohet asnjë supozim tjetër i identitetit.

Përputhja e ADN-së: Për qëllime të testimit të ICMP, përputhja e ADN-së përfshinë qëndrueshmërinë

gjenetike në mes të personit të zhdukur dhe të afërmve në dispozicion në atë mas sa mundësia e afërsisë është baraz ose më e madhe se 99.95%.

Përputhja e ADN-së: Procesi i krahasimit të profileve të ADN-së së mbetjeve të pidentifikuara njerëzore me profilet e ADN-së të mostrave referente, zakonisht nga anëtarët e familjes së personit të zhdukur. Kur nuk ka supozim të identitetit ky proces shpesh quhet “përputhje e verbër”.

Pragu i përputhjes: Është pragu paraprak për raportimin e përputhjes së ADN-së bazuar në rëndësinë statistikore të afërsisë së kalkuluar gjenetike me profiling e ADN-së të referencave familjare. Pragu minimal përputhës i ICMP për Raportin Përputhës të ADN-së është i vendosur në 99.95% të sigurisë për përputhjet e verbra.

Postmortem: Që i përke ose ngajnë pas periudhës së vdekjes; Ekzaminimi postmortem është term tjetër për autopsi.

Probabiliteti paraprak: Gjasat që mostra të vijë nga personi i zhdukur me emër, vlerësuar para kryerjes së çdo testi të ADN-së; Kjo jashtë mundë të shprehet matematikisht ose si “mundësi” ose probabilitet të cilat shpeshë ndërthuren. Në raportin përputhës të ADN-së të ICMP, mundësitë paraprake bazohen në numrin e personave të zhdukur nga rajoni i veçantë, konflikti apo ngjarja.

Probabiliteti i ngjashmërisë: Siguria statistikore e cila buron nga shumëfishimi i përpjestimit të mundshëm të ADN-së me mundësitë paraprake.

Pragu i raportuar: Shif Pragu i përputhjes.

Përpjestimi i Mundësisë: Është përpjestimi i probabilitetit të profileve të ADN-së në pyetje, i cili ndodh nën hipoteza të ndryshme. Është faktorë me të cilin të dhënat e ADN-së përkrahin hipotezën se mostra vjen nga personi i zhdukur me emër kundër hipotezës se mostra vjen nga një individë tjetër i cili nuk ka lidhje me personin e zhdukur në fjalë. Përpjestimi i mundësisë kombinohet me probabilitetin e mëhershëm për përcaktimin përfundimtarë të sigurisë (probabiliteti) së përputhjes.

Përsëritja e Vargjeve të Shkurtra (PVSH): Fusha të veçanta në kromozome ku pjesë të vogla të ADN-së (2 gjer në 6 baza për së gjati) janë të përsëritura saktësishtë disa herë. Këto lokuse të përcaktuara mire kanë dallim shumë të madh në mes të individëve dhe ofrojnë bazë veçanërishtë të forte për të dalluar individët.

Përqindja e zhvarrimeve: Përqindja e mostrave të parashtruara për nxjerrjen e ADN-së e cila rezulton me nxjerrjen e sukseshme të profilit.

R.

Ribashkimi: Procesi i bashkimit të elementëve skeletorë, të ndarë mëparë, të të njëjtit individë duke përdorur metodat antropologjike os/dhe të dhënat e ADN-së.

Raporti Krahasues Statistikor: Raporti i ADN-së i cili lëshohet në nivelin nën pragun statistikorë të sigurisë 99.95% për përputhje të plotë të ADN-së, për tu përdorur së bashku me faktet e ngjashme jo-ADN për të përkrahur identifikimin individual. Raporti Krahasues Statistikorë nuk përbën identifikim me ADN, ose fakt të vetëm në të cilin identifikimi me ADN duhet bërë.

Raporti Negativ: Shif Raporti përjashtues.

Raporti përputhës i ADN-së: Raporti i prodhuar formalishtë nga ICMP për të komunikuar gjetjen e përputhjes së ADN-së. Raporti i përputhjes së ADN-së shënon “identitetin e mundshëm” të personit të zhdukur dhe mostrave referente familjare me të cilat ADN-ja e personit të zhdukur është përputhur. Raporti përmban foto

dokumentacionin e mostrës së testuar postmortem dhe deklaratën përfundimtare e cila tregon hulumtimin statistikorë të përputhjes së ADN-së.

Raport përjashtues: Një raport zyrtar i shtypjes së ADN-së nga që tregon se të dhënat e ADN-së përjashtojnë hipotezën e veçantë supozuese për identitetin i cili është përcaktuar bazuar në të dhënat pa ADN.

Rasti i supozuar: Rasti i personit të zhdukur ku faktet jodefinite sugjerojnë hipotezën e identitetit para përfundimit të testit të ADN-së me qëllim të konfirmimit apo përjashtimit.

Rasti i Personit të Zhdukur: Për çëllime të punës së ICMP, është raporti i personit për të cilin familja e tij/sajë nuk ka informacion dhe i cili besohet të jetë zhdukur si pasojë e konfliktit të armatosur ose shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut; ose, mbetjet e paidentifikuara mortore të personit i cili besohet të jetë vrarë si pasojë e konflikteve të dhunshme ose/dhe shkeljes sistematike të të drejtave të njeriut.

S.

Shkalla e përputhjes së ADN-së: Masa në të cilën profilet e nxjerra nga mostrat e eshtrave të cilat përputhen me profilet e referencave familjare të ADN-së kur krahasimi farefisnor gjenetik është arritur.

Siguria statistikore: Shprehje e nivelit të besueshmërisë për hipotezën apo përfundimin, bazuar në kalkulim. Në rastin e raporteve përputhëse të ADN-së “probabiliteti posterior” është vlera e cila informon përdoruesin se me sa të “sigurt” ata mund të jenë në lidhje me hipotezën e identitetit në fjalë, bazuar vetëm në të dhënat e ADN-së.

T.

Të dhënat Postmortem: I referohen informative të marra nga një individë pas vdekjes. Shpeshë përfshinë profiling biologjikë: gjininë, moshën biologjike në vdekje, staturën, veçantitë e theksuara ose kushtet mjeksore.

V.

Varrezat Klandestine: Varrosja e mbetjeve njerëzore në vende sekrete ose të fshehura, çoftë e përbërë prej një trupi; trupave të shumfishtë; ose varrezë massive e cila përmban numër të madh të mbetjeve njerëzore. Këto varreza klandestine mund të jenë ‘Varreza primare, s.e. të zhvarrosura, të mbushura me një apo më shumë trupa; ose varrezë ‘Dytësore’ ku varreza origjinale ‘Primare’ është zhvarrosur dhe trupat janë lëvizur në një vend tjetër për tu rivarrosur në një varrezë klandestine ‘Dytësore’.

Zh.

Zhvarrimet: Nxjerrja e mbetjeve njerëzore të varrosura nga varreza e ditur, shpeshë me identifikim të ditur dhe e gjetur në varrezat lokale. Përparsi i jepet më shumë zhvarrimit të mbetjeve njerëzore dhe artefakteve me mbetjet, përkundrejt zhvarrimit të detajuar dhe ekzaminimit mjekoligjorë të mjedisit të varrezës, dhe shënimi dhe zhvarrimi i fakteve gjeologjike, ekofaktuale ose artefakteve të ndërlydhura me vendvarrimin ose varrezën në vete.